

Enver Hoxha

"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



PKSH FESTON ME MADHËSHTI 100 VJETORIN E LINDJES SË ENVER HOXHËS

- Morën pjesë delegacione të Partive Komuniste nga Brazili, Spanja, Greqia, Franca, Turqia, Belgjika, Danimarka, Italia etj. Nderuan me pjesëmarrjen e tyre personalitete e patriotë nga shume krahina të Kosovës. Në Konferencën Kombëtare kushtuar Enver Hoxhës mbajti një referat të rëndësishëm në emër të PKSH Hysni Milloshi. Referatin në emër të kosovarëve e mbajti Profesor Remzi Hasani. Në konferencë mbajtën fjalime edhe shokët e huaj marksistë-leninistë Raul Marko, Vim Kenis, Bruno Morand, Mehmet Ozer, Jorgo Havatzas e Bernardo Jofili. Konferenca u ndoq nga gazetarë të huaj. PKSH ka marrë shumë telegrame nga lëvizja komuniste ndërkombëtare.

FJALA E HAPJES E SHOKUT MUHARREM XHAFJA, SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I PKSH

Shokë dhe shoqe,

Më lejoni që në emër të KQ të PKSH të çel Sesionin Jubilar kushtuar Enver Hoxhës në 100 vjetorin e lindjes së tij.

Në sesion marrin pjesë komunistë, veteranë, simpatizantë të Enver Hoxhës nga të gjitha rrethet e vendit, nga Kosova e diaspora dhe përfaqësues të organizatave e shoqatave të ndryshme. Na ndërojnë me pjesëmarrjen e tyre i dërguari i

familjes Hoxha, Dritan Kolaneci, nipi i Enver Hoxhës dhe i Heroit të Popullit Teki Kolaneci dhe të ftuar nga parti të tjera si ajo „8 Nëntori“.

Në emër të KQ të PKSH ju përshëndes e ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen në këtë veprimtari të rëndësishme përkujtimore kushtuar udhëheqësit të Partisë tonë Komuniste dhe për mbështetjen që i jepni PKSH-së.

Me ftesë të KQ të PKSH kanë ardhur për të marrë pjesë në Sesionin Jubilar dhe në veprimtaritë të tjera për 100 vjetorin e lindjes së shokut Enver disa delegacione të partive komuniste e punëtore motra nga vende të ndryshme:

delegacioni i PK të Brazilit i kryesuar nga shoku Barnardo Jofili,

delegacioni i Partisë së Punës të Belgjikës i kryesuar nga shoku Vim Kenis,

delegacioni i Kolektivit Militant Komunist të Francës i kryesuar nga shoku Bruno Morand,

delegacioni i Partisë së Punës të Turqisë i kryesuar nga shoku Mehmet Ozer,

delegacioni i PK (m-l) të Spanjës i kryesuar nga shoku Raul Marko.

Presim të vinë në këto çaste delegacionin e PK të Greqisë, delegacionin e Partisë të Komunistëve të Italisë dhe dy gazetarë danezë.

Duke shprehur edhe mendimin tuaj, më lejoni të falenderoj për pjesëmarrjen delegacionet e partive motra të pranishëm dhe t'u deklaroj se pjesëmarrja e tyre është një vlerësin i madh që i bëhet Enver Hoxhës e veprës së tij, një mbështetje e sinqërtë për PKSH-në dhe një shprehje e lartë e bashkëpunimit ndërkombëtar midis partive komuniste e punëtore marksiste-leniniste.

Shokë dhe shoqe,

Partia jonë vjen në këtë Sesion Jubilar pas shumë veprimtarish serioze të kryera në rrethe në nderim të jetës e të veprës së Enver Hoxhës. Por, sado që të bëjmë e çfarëdo që bëjmë në nderim të tij, ne komunistët mbetemi gjithmonë borxhlinj ndaj këtij burri të madh e udhëheqësi të shquar e të lavdjshëm komunist.

Epokat historike kanë nevojë për udhëheqës dhe ato i nxjerrin udhëheqësit për t'u prirë masave popullore drejt progresit ekonomik, shoqëror e politik. Enver Hoxha është një ndër udhëheqësit që ka bërë epokë si vazhdues i kolosëve Marks, Engels, Lenin e Stalin.

Enver Hoxha i kreu me nder detyrat ndaj epokës së tij. Ai është një nga ata udhëheqës që koha ua rritë vlerat dhe i bën më të dashur për popullin, është një nga ata udhëheqës që i përkasin sa kohës që jetojnë, aq edhe së ardhmes, është nga ata udhëheqës komunistë që kurrë nuk i zë pluhuri i harresës. Vepra revolucionare e Enver Hoxhës është e pavdekshme, mësimet e tij do të na udhëheqin drejt rivendosjes së pushtetit popullor dhe socializmit në Shqipëri, do të na frymëzojnë për t'i qëndruar besnik mësimëve të marksizëm-leninizmit.

Shokë dhe shoqe,

Është hedhur shumë baltë mbi Enver Hoxhën e veprën e tij. Në 100 vjetorin e lindjes së Enverit, reaksioni shqiptar nuk ka lënë gjë pa thënë e pa bërë kundër tij. Sepse Enver Hoxha, edhe pse fizikisht i vdekur, i tmerron armiqtë e popullit, të revolucionit e të socializmit. Po koha punon për popujt, për socializmin, kapitalizmi e ka jetuar kohën e tij. Koha po vërteton mësimet e Enver Hoxhës, breznitë e reja, sado vonë, do t'u kthehen mësimet të Enver Hoxhës. Me Enverin do të ndodhë ashtu siç ka ndodhur me Skënderbeun; historia do t'i japë atij të drejtë.

Lavdi shokut Enver Hoxha, themeluesit të PKSH-së, Komandantit të Përgjithshëm të LANÇ-ës dhe udhëheqësit të shquar të Partisë Komuniste (PPSH) e të popullit shqiptar!

Dhe tani më lejoni që t'i jap fjalën shokut Hysni Milloshi, Kryetar i PKSH për të mbajtur referatin „Përse i janë mirënjohës historia kombëtare dhe populli shqiptar Enver Hoxhës“.